



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 3 gusht 2020
Nr. ref.: RK 1597/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI113/19

Parashtrues

Islam Qerimi

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 3 [Autorizimet e noterit dhe dokumentet noteriale] të Ligjit Nr.06/L-010 për Noterinë dhe për interpretimin e tij

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Islam Qerimi (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), që të bëjë interpretimin e nenit 3 [Autorizimet e noterit dhe dokumentet noteriale], të Ligjit nr. 06/L-010, për Noterinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Noterinë), të 26 dhjetorit 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 3 [Autorizimet e noterit dhe dokumentet noteriale] të Ligjit për Noterinë, dhe njëkohësisht kërkesës së parashtruesit për interpretimin të po të njëjtit nen, i cili, sipas parashtruesit, shkel të drejtën e tij të garantuar me nenin 3 [Barazia para Ligjit], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113 (1) dhe (7) të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit [nr. 03/L-121] për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve], të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 2 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 3 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Nexhmi Rexhepi.
7. Më 24 korrik 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës.
8. Në të njëjtën datë, Gjykata iu dërgoi nga një kopje të kërkesës Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kuvendi), Ministrisë së Drejtësisë dhe Odës së Noterëve, si palë të interesuara. Gjykata iu dha afat që të paraqesin komentet e tyre, nëse kanë, deri më 6 gusht 2019. Gjykata nuk pranoi ndonjë koment lidhur me këtë kërkesë.
9. Më 9 korrik 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarin raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 23 nëntor 2018, Kuvendi e miratoi Ligjin për Noterinë. Në nenin 78 [Hyrja në Fuqi], të Ligjit në fjalë, u theksua se ligji do të hyjë në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gazeta Zyrtare).

11. Më 26 dhjetor 2018, Ligji për Noterinë u publikua në Gazetën Zyrtare.
12. Më 2 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesën e tij në Gjykatë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se neni 3 [Autorizimet e noterit dhe dokumentet noteriale], i Ligjit për Noterinë, i shkel të drejtat e tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
14. Parashtruesi fillimisht sqaron se, *“Ne baze të Ligjit për shoqëritë Tregtare Ligji nr.06/L -016, ne jemi të regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit, me nr. 810055378, emri i biznesit është "Law Tech" sh.p.k. Si aktivitete kemi këshillimin e klientëve në lëminë Juridike, civile, ekonomike dhe administrative [..]”*.
15. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të bëjë interpretimin e Ligjit për Noterinë, duke u përgjigjur në disa pyetje specifike si në vijim:
 - (i) *“A mundet një Zyre për Konsulencë Ligjore e regjistruar pranë ARBK-së apo një Zyre e Avokatisë e regjistruar në Odën e Avokatëve, të hartoj kontrata për paluajtshmëri, dhe cilat lloje të kontratave mund të hartohen?”*
 - (ii) *A mund të përfaqësoj klient të saj tek një Organ Administrativ, dhe a mund të përfaqësoj në bazë të Autorizimit të dhënë nga Klienti, që të përfaqësoj në një Kontest civil, administrativ, ekonomik, pranë gjykatës kompetente?*
 - (iii) *Autorizimi që jep klienti për Zyrën Ligjore “Law Tech”, a ka vlefshmëri edhe pa u vërtetuar nga noteri.;*
 - (iv) *Çfarë veprimtari mund të ushtrojë një Zyre Ligjore e Licencuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë?”*
16. Parashtruesi i kërkesës thekson se në bazë të Kushtetutës, *“të gjithë jemi të barabartë para ligjit, dhe nëse në asnjë nen të ligjeve të cekura nuk specifikohet se kompetencë ekskluzive për hartimin e shkresave të lartë cekura është e noterit, apo se ndalohet kompensimi për persona tjerë përveç avokatëve siç pretendon Oda e Përmbaruesve të Kosovës, atëherë shkelet konkurrenca e lirë dhe shkelet dispozita kushtetuese që të gjithë jemi të barabartë para Ligjit siç është neni 3 i Kushtetutës.”*
17. Më tutje, parashtruesi i kërkesës thekson se nëse atij i lejohet që të regjistrojë një zyre ligjore dhe të paguaj tatimet që janë të përcaktuara me ligj, atëherë *“nuk e kuptoj se si mundet me u interpretuar ndryshe, ligjet në fuqi, ku në asnjë dispozitë nuk përcaktohet që kompetencë ekskluzive e noterit është hartimi i kontratave të paluajtshmërisë.”* Kjo, sipas pretendimit të parashtruesit, *“përbën një monopol të Odës së Noterëve të Kosovës, dhe po ashtu ku po mbetet rëndësia e Avokatit apo Konsulentit Ligjor.”*

18. Parashtruesi i kërkesës kërkon sqarim se zyra ligjore që ai e përfaqëson a mund të përfaqësoj klientët e saj tek një organ administrativ dhe a mundet që, në bazë të autorizimit të dhënë nga klienti, të përfaqësoj atë në një kontest civil, administrativ, ekonomik, pranë gjykatave kompetente.
19. Më tej parashtruesi i kërkesës pyet se autorizimi që jepet nga klienti për zyrën ligjore, a ka vlefshmëri edhe pa u vërtetuar nga noteri. Po ashtu ai thekson se *“në bazë të Odës së Përmbaruesve Privat, një zyre ligjore nuk mund të kompensohet për hartimin e propozimit për përmbarim, dhe se e njëjta nuk mund të kompensohet, mirëpo duhet patjetër të jetë avokat, ndërkaq në ligj nuk figuron një gjë e tillë askund”*.
20. Në pjesën e formularit në të cilën duhet të shpjegohet se a ka pasur edhe ndonjë mjet tjetër juridik që parashtruesi ka pasur mundësi ta shterojë, parashtruesi i kërkesës është përgjigjur duke theksuar se *“nuk ka mundësi të interpretimit tjetër përveç në Gjykatën Kushtetuese për këto ligje, është paksa unike kjo kërkesë mirëpo është e vetmja mënyrë për të sqaruar këtë çështje shumë delikate, pasi që ne kemi problem në ushtrimin e punës tonë, të cilën e garanton Ligji.”*
21. Në fund, parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesës si në vijim:

“Dëshirojë që përmes kësaj shkrese të sqarohet se çfarë kompetence kanë noterët, cilat kompetenca ka avokati, dhe se a mundet një Zyre Ligjore e regjistruar pranë Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, që të përfaqësoj klientët në konteste civile pranë administratës shtetërore dhe gjykatave kompetente, në rast të hartimit të propozimit për përmbarim, a mund të kompensohet për të njëjtin në momentin e ekzekutimit të propozimit nga përmbaruesi? Dhe autorizimi i dhënë për përfaqësim nga klient, forma e autorizimit e hartuar nga Zyra për Konsulencë Ligjore, a ka nevojë për noterizim apo ka vlefshmëri të njëjtë.”

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1, 7 dhe 8, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar;

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

8. Gjykatat kanë të drejtë t'i referojnë Gjykatës Kushtetuese çështje përkitazi me përputhshmërinë kushtetuese të një ligji, nëse ajo përputhshmëri është ngritur gjatë procedurës gjyqësore dhe gjykata referuese nuk është e sigurt për përputhshmërinë e ligjit të kontestuar me Kushtetutën dhe nëse vendimi i gjykatës referuese për rastin e caktuar, varet nga përputhshmëria e ligjit në fjalë.

24. Gjykata, gjithashtu, i referohet neneve 47 [Kërkesa Individuale] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, i cili përcakton:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 49
[Afatet]

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi.

25. Më tej, Gjykata vlerëson nëse janë plotësuar kriteret e parapara me rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, i cili përcakton që:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

(a) Kërkesa parashtrohet nga një palë e autorizuar”.

26. Fillimisht, Gjykata vë në dukje se parashtruesi konteston kushtetutshmërinë e Ligjit për Noterinë. Ai pretendon se neni 3 [Autorizimet e noterit dhe dokumentet noteriale], i Ligjit për Noterinë, dëmton konkurrencën e lirë dhe barazinë para ligjit. Në këtë drejtim, ai argumenton se “[...]”nëse në asnjë nen të ligjeve të cekura nuk specifikohet se kompetencë ekskluzive për hartimin e shkresave të lartë cekura është e noterit, apo se ndalohet kompensimi për persona tjerë përveç avokatëve siç pretendon Oda e Përmbaruesve të Kosovës, atëherë shkelet konkurrenca e lirë dhe shkelet dispozita kushtetuese që të gjithë jemi të barabartë para Ligjit”. Lidhur me këtë, ai kërkon nga Gjykata që të bëjë interpretimin e Ligjit për Noterinë, duke u përgjigjur në një numër të caktuar të pyetjeve të tij (të pasqyruara të gjitha gjerësisht në pjesën e pretendimeve të parashtruesit).

27. Në zbatim të dispozitave gjegjëse kushtetuese, të cilat shërbejnë si bazë për vlerësim të kësaj kërkesë, Gjykata referohet në nenin 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i të Kushtetutës, i cili përcakton kush janë palët e

autorizuara që kanë të drejtë të kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjeve. Në këtë vazhde, Gjykata thekson se, sipas nenit 113 të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të Ligjit dhe të Rregullores së punës, individët nuk janë të autorizuar të parashtrojnë në Gjykatën Kushtetuese kërkesa që janë të karakterit *actio popularis*. E vetmja mënyrë se si personat fizikë ose juridikë mund të kontestojnë kushtetutshmërinë e një ligji para Gjykatës Kushtetuese përmes nenit 113.7 të Kushtetutës dhe neneve 47 dhe 49 të Ligjit, është nëse ata dëshmojnë se kërkesa e tyre nuk është e karakterit "*actio popularis*" – por që ata janë prekur nga një "ligj" në mënyrë direkte dhe të drejtpërdrejtë, në mungesë të ndonjë akti, vendimi ose mase që zbaton atë ligj. Në rrethanat e rastit konkret, siç do të shpjegohet më tutje, ky nuk është rasti.

28. Në lidhje me këtë, Gjykata sjellë në vëmendje praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, përkritazi me interpretimin e nenit 113 të Kushtetutës, e cila vë në pah se personat, fizikë apo juridikë, nuk kanë të drejtë të kontestojnë *in abstracto* akte normative të karakterit të përgjithshëm (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI05/17 parashtrues Osman Sylanaj, Aktvendim për Papranueshmëri i 20 nëntorit 2017; KI102/17 parashtrues Meleq Ymeri, Aktvendim për Papranueshmëri i 10 janarit 2018; KI196/18 parashtrues Dardan Bunjaku, Aktvendim për Papranueshmëri i 23 prillit 2019).
29. Pra, sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, Kushtetuta nuk parasheh mundësi që individët të mund të ankohen në Gjykatën Kushtetuese, *in abstracto*, për jo-kushtetutshmëri të një Ligji. Individët mund të parashtrojnë kërkesë kushtetuese, sa i përket veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, vetëm përbrenda fushëveprimit të përcaktuar me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, që kërkon që parashtruesit të dëshmojnë se janë: (1) palë të autorizuar, (2) të prekur drejtpërsëdrejti nga akti konkret i një autoriteti publik ose mosveprimi i autoritetit publik, dhe (3) se kanë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI102/17 parashtrues *Meleq Ymeri*, cituar më lart, paragrafi 20).
30. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se ajo nuk mund të përgjigjet në pyetjet dhe mëdyshjet e aplikueshmërisë së Ligjit për Noterinë, që parashtruesi i kërkesës i ka paraqitur, në mënyrë abstrakte, përmes kërkesës së tij.
31. Lidhur me Ligjin për Noterinë, Gjykata vë në dukje se veçse ka shqyrtuar një rast ku është kërkuar "*Vlerësim i kushtetutshmërisë së nenit 32 (paragrafi 1), nenit 41 (paragrafët 1.3 dhe 1.4) dhe nenit 76 (paragrafi 2), në lidhje me nenin 2 (paragrafi 7) dhe nenin 22 (paragrafi 1.3) të Ligjit nr. 06/L-010 për Noterinë*". Kërkesa ishte parashtruar nga Avokati i Popullit dhe Gjykata kishte nxjerrë një Aktgjykim lidhur me këtë rast, pasi që kishte konstatuar se Avokati i Popullit ishte palë e autorizuar për të kontestuar kushtetutshmërinë e këtyre neneve të Ligjit për Noterinë (Shih, rasti KO65/19, parashtrues Avokati i Popullit, Aktgjykim i 29 korrikut 2019).
32. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit duhet të shpallet e papranueshme sepse nuk është dorëzuar nga një palë e autorizuar, siç përcaktohet me paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit si dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (a) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 9 korrik 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi